



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më __.06.2022

MBLEDHJA Nr. 25,
Datë 10.06.2022, ora 13:00
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Premte, datë 10.06.2022, ora 13:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 25 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbalit të mbledhjes së bordit të ERE-s më datë 06.06.2022
2. Mbi përcaktimin e çmimit të shitjes së energjisë elektrike nga furnizuesi i mundësisë së fundit për muajin Maj 2022
3. Mbi licencimin e shoqërisë “Salillari Energy Trade” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “Danske Commodities Albania” sh.p.k., për rinovimin e licencës nr. 374, seria T12/T17 në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 04.07.2017
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “PPC Albania” sh.p.k. për rinovimin e licencës nr. 373, seria T17, në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 93, datë 04.07.2017
6. Mbi kërkesën e shoqërisë “SA-GLE Kompani” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e saj
7. Çështje të tjera

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI